



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**Procesverbal**

**nga dëgjimi buxhetor me qytetarët e Komunës së Podujevës për përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2020-2022, i mbajtur më 12 qershor 2019**

**Takimi filloi në orën 11.05**

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Agim Veli, takimin publik e hapi dhe e kryesoi, z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës.

Në takim ishte i pranishëm një numër i konsideruar i qytetarëve (52 pjesëmarrës), përfaqësues të OJQ-ve, Drejtorët e Drejtorive të Administratës së Komunës, përfaqësues të OSBE-së, dhe përfaqësues të mediave.

**Tema: Korniza Afatmesme Buxhetore 2020- 2022**

z. **Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës**, Qytetarë të nderuar ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe ju dëshiroj mirëseardhje në këtë takim. Kryetari i Komunës z. Agim Veliu për shkak të angazhimeve, sot nuk mund të jetë prezentë në këtë takim.

Në kuadër të autorizimeve ligjore dhe të Qarkores buxhetore 2020/01, jeni ftuar që të jeni pjesëmarrës në përgatitjen e Planifikimit të buxhetit të Komunës (Kornizën Afatmesme Buxhetore-KAB) për periudhën 2020-2022. Pra qëllimi është për të bërë një planifikim sa më të mirë. Ne do të marrim kërkesat e juaja, të cilat do të shqyrtohen dhe sigurisht varësisht prioriteteve dhe mundësive buxhetore do të përfshihen në planin buxhetor. Sipas Qarkores buxhetore 2020/01 kemi një rritje të buxhetit që parashihet në vazhdimësi për tre vitet e ardhshme. Kjo do të na ofrojë mundësi më të mirë për akomodimin e kërkesave të komuniteteve që Ju përfaqësoni. Nënkyetari i njoftoi për procesin e miratimit të KAB-it dhe projektbuxhetit për vitin 2020 dhe për kufijtë buxhetor.

Hapja e debatit.

**z. Sabit Mehmeti, nga fshati Shajkoc**, kërkoi të futet në planifikim vazhdimi i asfaltimit të një rruge në fshat, e cila ka mbetur në gjysmë, ku 10 familje qarkullojnë për atë rrugë.

**z. Naim Murseli, nga fshati Sallabajë**, shtroi kërkesë për asfaltimin e një rruge në lagjen ‘Murseli’ të fshatit Sallabajë në gjatësi rreth 60 m. Si dhe kërkesën për vendosjen e tabelave të emërtimeve të rrugëve të fshatit.

**z. Sejdi Kamberi, përfaqësues i fshatit Majac**, kërkoi të planifikohet asfaltimi i rrugicave të fshatit me rreth 4 km gjatësi të përgjithshme. Theksoi, kemi problem edhe me kanalizimin. Gjithashtu kërkoi që në planifikim të përfshihen edhe dy rrugë për lidhjen e fshatit me fshatrat Llapashticë dhe Zhegrovë.

**z. Arif Demiri nga fshati Kaqybeg**, paraqiti kërkesë për përfshirje në planifikim:

- Asfaltimi i 4 rrugëve të fshatit ; Pastrimin e një fushe nga mbeturinat dhe në hapësirën e njëjtë ndërtimin e një fushe sportive; Ndriçimin e rrugës, Ndërtimin e trotuareve dhe Sigurimin e transportit për nxënës.

**z. Osman Bahtiri, përfaqësues i fshatit Gllamnik**, fillimisht falënderoi ekzekutivin e Komunës për investimet e bëra në fshat. Paraqiti disa kërkesa për investime në fshat dhe atë; Renovimin e një pjese të trotuarit në disa lagje; Ndërtimi i një pjese të kanalizimit që ka mbetur pa u përfunduar dhe renovimi i një pjese të tij për shkak të pengesave dhe mbylljes; Ndërtimin e rrugës që lidh fshatin Siboc; Asfaltimin e një numri të rrugicave të fshatit në

gjatësi të përgjithshme prej 2 km; Riparimin e rrethojës së oborrit të shkollës. Ndër tjera shtoi, problem për banorët e fshatit paraqet lidhja me rrugën magjistrale. Kjo duhet sqaruar nga autoritetet, duhet të na bëhet zgjidhje.

**z. Fadil Gërguri, përfaqësues i fshatit Siboc i Poshtëm**, paraqiti kërkesë që në planin e buxhetit të parashihet ndërtimi i disa rrugëve të fshatit, si dhe ndërtimi i trotuarit.

**z. Bekim Babatinca, përfaqësues i lagjeve Babatinca, Stubllakëve, Arbanashëve, Visokë, Bebushë**, shtroi kërkesë që në planifikim të përfshihet; Ndërtimi i një trotuari në rrugën nga Restoranti “Nobel” që vazhdon deri te lumi Llap; Shtrirjen e rrjetit të ndriçimit; Asfaltimin e disa rrugicave në lagjen e “Babatincëve” në gjatësi rreth 800 m gjithsejtë dhe për ndërtimin e trotuarit në rrugën “Dëshmorët” deri te hoteli Besiana. Kam edhe një kërkesë lidhur me tregun e qytetit. Është një treg shumë mirë i ndërtuar por ka probleme rreth sistemimit të tregtarëve, ku si pasojë ka ngatërresa. Unë po flas në emër të një grupi të tregtarëve fermerë, do të ishte mirë të aplikohet hyrja dhe sistemimi me pagesë dhe të caktohet ndonjë person zyrtar për të krijuar rregull.

**z. Xhafer Ademi**, fillimisht falënderoj drejtorët që na ka ndihmuar në të gjitha projektet që i kemi pas. Ndër tjera shtroi kërkesë që të planifikohet për rregullimin/ riparimin e kanalizimit në lagjen “Xhafer Meta”, pasi që ka probleme sidomos kur ka reshje të mëdha të shiut. Në lagjen “Ali Ajeti” duhet patjetër të ndërrohet rrjeti i ujës-jellësit për shkak të vjetërsimit të tij, ku si pasojë ka dëmtime të shpeshta. Kërkesë tjetër për komunitetin ashkali është ngritja e një qendre rinore që do të shërbente edhe për të tjerët, për aktivitete të ndryshme.

**z. Ramush Jupolli, përfaqësues i fshatit Shajkoc**, theksoi në fshatin Shajkoc është punuar bukur shumë dhe për këtë falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive. Gjithashtu kam disa kërkesa për planifikim, dhe atë; Vazhdimin në asfaltimin e pjesës së rrugës që e theksoi edhe bashkëvendësi, ku Ministria nuk e ka vazhduar projektin në tërësi dhe këtë ndarje e ka bërë në baza politike. Kërkesë tjetër është shtrirja e rrjetit të ndriçimit dhe asfaltimi i disa rrugicave në disa lagje të fshatit.

**z. Arton Mengjiqi, përfaqësues i fshatit Lupç i Epërm**, kërkoj që në planifikim të përfshihet rregullimi i shtratit të një pjese të përroskës së fshatit, pasi që një pjesë është rregulluar më herët, pas reshjeve të mëdha uji po vërshon dhe po shkatërron asfaltin.

**z. Avdullah Jaha**, shtroi kërkesë për rregullimin e rrugës në fshatin Reçicë. Theksoi, fshati ka fermerë dhe duhet krijuar kushte për zhvillimin e bujqësisë, kështu që është shumë e nevojshme asfaltimi i rrugës.

**z. Nuredin Hyseni, përfaqësues i fshatit Bellopojë**, theksoi, nuk kam ndonjë kërkesë tani për tani por desha të shpreh një falënderim për punët e shumta që janë kryer.

**z. Raif Osmani, nga fshati Dumnice e Epërme**, shtroi kërkesë për planifikimin e asfaltimit të rrugës nga lagja e Jahollëve për tu lidhur me fshatin, si dhe kërkesën për sigurimin e transportit për nxënës të fshatit.

**z. Esat Ejupi, lagja Sekiraçë**, theksoi, në lagje është punuar bukur shumë megjithatë janë edhe disa rrugica në gjatësi të përgjithshme prej 1135 m, që është shumë e nevojshme të përfshihen në planifikimin buxhetor për asfaltim.

**z. Sabri Pollomi, nga fshati Balloc**, theksoi, është duke u punuar në asfaltimin e një rruge në fshatin Balloc, projekti ishte 750 m, ku na përfshinte edhe lagjen tonë “Pollomët” dhe lagjen “Naser Bajgora”, mirëpo në ndërkohë deklaruan se do asfaltohet vetëm 700 m gjatësi, ku ne si lagje do të anashkalohehi nga ky projekt. Do donim të sqarohet kjo çështje.

**z. Muhamet Podvorica, përfaqësues i fshatit Tërnavë**, theksoi, me ndarjen e subvencioneve nga Komuna në fshatin Tërnavë jemi të anashkaluar. Sa i përket kërkesave, kërkoj që të sigurohet transport për nxënësit e klasave të ulëta sepse duhet kaluar një rrugë prej 3 km. Kanalizimi në fshat ka mbetur gjysmë, i pa përfunduar. Një rrugë për në lagjen e Vllahive është e gjatë 2300 m është shumë e rëndësishme dhe ka nevojë të asfaltohet. Kërkoj që këto kërkesa të hyjnë në planin e buxhetit.

**z. Nexhmi Rudari, Nënkryetari i Komunës,** theksoi, po jap një përgjigje sa i përket transportit të nxënësve pasi që drejtori i DKA-së nuk është në takim, kjo çështje është e rregulluar me ligj edhe pse në ndonjë vend kemi bërë përjashtim, kemi siguruar transportin, kur kemi vlerësuar se është shkallë e lartë e rrezikshmërisë (ecja e nxënësve nëpër rrugën magjistrale). Nxënësit të cilët nuk e kalojnë distancën në një drejtim 4 km nuk u sigurohet transporti. Ju njoftoj se i kemi edhe tri debate publike brenda këtyre pak ditëve, me datën 17 qershor kemi Draft Rregulloren për Mbrojtjen e Mjedisit; 18 qershor debatin për Draft Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave dhe me datën 21 qershor debati me qytetar për ecurinë e realizimit të projekteve për vitin 2019, ndërsa sot jemi duke debatuar lidhur me kërkesat për planifikimin e buxhetit për vitin 2020 dhe parashikimet 2021 /2022.

**z. Naim Murseli, nga fshati Sallabajë,** theksoi, kam edhe një kërkesë që ka të bëjë me Ministrinë e Shëndetësisë ose me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Jam në dijeni se Komuna e Prishtinës ka të themeluar një institucion jashtë atij të Emergjencës i cili është duke kryer shërbime kronike në fshatrat përreth. A ka mundësi që edhe në Komunën e Podujevës të parashihet dhe të ngritet institucion i njëjtë shëndetësor, duke marrë parasysh numrin e madh të rasteve kronike që kemi, pasi që ky shërbim do të ishte edhe lehtësim për shërbimin e emergjencës.

**z. Nexhmi Rudari, Nënkryetari i Komunës,** pasi që përfundam me paraqitjen e kërkesave buxhetore, fjalën e kanë Drejtorët e Drejtorive.

**z. Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik,** theksoi të gjitha kërkesat e paraqitura nga ana e juaj për investime kapitale do të shqyrtohen dhe analizohen me seriozitet dhe do të merren parasysh ato me prioritet, natyrisht varësisht mundësive buxhetore dhe të njëjtat do të përfshihen në sistem. Ne në bashkëpunim dhe koordinim me përfaqësuesit e fshatrave i zgjedhim projektet me prioritet më të madh, natyrisht duke trajtuar secilin fshat me radhë. Dua të ju informoj se për vitin e ardhshëm buxheti do të jetë më i cunguar në aspektin e investimeve në fshatra. Do t'i përkushtohemi më tepër qytetit sepse ka mbetur mbrapa në investime. Kemi sheshin e qytetit që kërkon një buxhet të konsiderueshëm, projekt i cili do të fillojë këtë vit. Pra për vitin e ardhshëm duhet ndarë buxhet së paku 2 mil € për këtë projekt. Megjithatë për një trajtim më të mirë ne do të bëjmë përpjekje me buxhetin që kemi por edhe në koordinim me Ministrinë.

**z. Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit,** theksoi, do të jem i shkurtër dhe konkret për të gjitha kërkesat e paraqitura. Duke marrë përbazë projektet që janë realizuar dhe që janë në proces të realizimit nëpër fshatra, do të shqyrtohen dhe vlerësohen të gjitha kërkesat e paraqitura, dhe në kuadër të kufijve të lejuar buxhetor, në koordinim me Ju, do të parashohim projektet për vitin 2020 dhe parashikimet për vitet 2021/2022. Drejtori pasqyroi në detaje projektet që aktualisht janë duke u realizuar dhe për mundësitë e planifikimeve.

**z. Zaim Thaçi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,** në këtë takim u ngritën dy çështje në fushën e shëndetësisë, e para që ka të bëjë me parkingun dhe rrethojën e objektit të AMF në fshatin Gllamnik, është fakt se është pran rrugës magjistrale dhe kur kanë filluar punimet në rrugë është prekur rrethoja dhe një pjesë të gjelbërimit. Mendoj që pas përfundimit të të gjitha punimeve në magjistrale ne do të rregullojmë rrethojën e objektit, por më shqetësuese do të jetë sigurimi i parkingut për shkak të zvogëlimit të hapësirës për shkak të zgjerimit të rrugës, por do të merremi me këtë çështje. Sa i përket çështjes tjetër që i referohet shërbimit kronik në fshatra, sa për informatë, në shërbimin e Emergjencës i kemi dy ekiye mjekësore, me qëllim që njëri ekip të jetë mobil, për t'u ofruar shërbime qytetarëve edhe në shtëpi, aty ku ekipi vlerëson se është në pyetje jeta e pacientit. Në Ligjin e mëparshëm për Shëndetësi ka ekzistuar shërbimi kronik, por me Ligjin në fuqi ky shërbim nuk parashihet. Mbetet obligim i të gjitha pikave shëndetësore për të ofruar këtë shërbim.

**z. Vezir Januzi, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,** theksoi, nga takimi kam pritur një interesim më të madh sa i përket investimeve në bujqësi, e cila

Ilogaritet edhe si shtyllë kryesore e zhvillimit ekonomik në Komunën tonë. Kryetari i Komunës z. Agim Veliu sektorin e bujqësisë e ka vendosur në prioritetin më të lartë dhe besoj se në dy vitet e fundit në Kosovë jemi lidere me investime në fushën e bujqësisë. Ndarja e subvencioneve bëhet në përputhje të plotë me Rregulloren komunale për ndarjen e subvencioneve. Këtë vit kemi filluar me një numër projektsh, ku disa janë realizuar dhe ca janë në proces. Për vitet sipas KAB-it do të planifikojmë projekte të rëndësishme.

**z. Nexhmi Rudari, Nënkyetari i Komunës**, falënderojmë Drejtorët për këto sqarime, ne me kaq po e përmbyllim këtë debat, duke ju falënderuar të gjithëve për kontributin e dhënë. Propozimet do të shqyrtohen dhe varësisht mundësive buxhetore do të merren parasysh.

**Mbledhja përfundoi në orën 12.30**

**Procesverbalin e mbajti  
Sabedin Namani**

**Nr. 02-400/02-0048314 /19  
Podujevë, 12.06.2019**

**Nënkyetari i Komunës  
Nexhmi Rudari**